



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 311 Prot.

Tiranë, më 12.2.2026

**URDHËR**

Nr. 36, datë 12.2.2026

***“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË KONKURRIMET E PLANIFIKUARA PËR T’U ZHVILLUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE GJATË VITIT 2026, ME PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV NË SHËRBIMIN CIVIL, LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)”***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 82, datë 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i “mbikëqyrjes së orientuar”, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të disa prej procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2026.

## **Për këtë arsye,**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 82, datë 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2026,

## **URDHËROJ:**

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2026.

2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

<b>1. Luiseda Zhapa</b>	Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
<b>2. Antea Kabali</b>	Inspektore (Përgjegjës grupi)
<b>3. Sabina Liço</b>	Inspektore (Anëtar)
<b>4. Have Brahollari</b>	Inspektore (Anëtar)

3. Metodologjia që do të ndiqet për realizimin e mbikëqyrjes së orientuar:

- Përfshin mbledhjen e të dhënave nga grupi i punës, i cili do të marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa prej procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, për të gjitha nivelet e nëpunësisë;
- Për dokumentimin e procesit të mbikëqyrjes do të këqyren të gjitha aktet e publikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, duke i pasqyruar të dhënat e nxjerra nga këto akte, në formë tabelare (excel) me qëllim përpunimin e tyre;
- Me përzgjedhje, grupi i punës i ngarkuar me këtë proces, do të ndjekë disa nga procedurat e konkurrimit, duke e evidentuar këtë proces përmes kopjeve të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës së konkurrimit, si dhe procesverbalin e këqyrjes të mbajtur nga grupi i punës për këtë qëllim.

4. Me përfundimin e afatit të mbikëqyrjes, do të përgatitet relacioni dhe raporti përkatës, ku do të pasqyrohet informacioni i administruar dhe propozimet përkatëse për mënyrën e ndjekjes së problemeve të evidentuara.
5. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
6. Me këtë urdhër të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë urdhër.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Lefterije Lleshi (Luzi)**